

Disa çështje me rëndësi lidhur me karakteristikat dhe teknikën juridike të lidhjes së kontratave formulare

Hyrje

Marrëdhëniet ekonomike gjithnjë më të zhvilluara, forma e prodhimit e industrializuar, koncentrimi i madh i kapitalit, kanë shkaktuar marrëdhënie të reja shoqërore të ekonomisë së tregut, e si rrjedhim edhe marrëdhënie juridike të ndryshme jo vetëm për nga lloji, po edhe nga përmbajtja dhe forma. Kontratat e sotme formulare nuk kanë ekzistuar më parë, sepse jeta nuk i ka imponuar. Përmbajtja dhe forma e kontratave të sotme është e ndryshme nga ajo që ka qenë më herët.

Me ndryshimin e marrëdhënieve shoqërore e posaçërisht të atyre ekonomike, shpeshherë e kërkon nevoja që kontrata të lidhet shpejt, e kjo ka bërë që të krijohen shabllone, formularë për lidhjen e kontratës. Rritja e standardit jetësor ka imponuar lidhjen e kontratave të caktuara formulare që kanë elementin e domosdoshmërisë.

Kontratat formulare janë të shpeshta në qarkullimin ekonomik. Kjo dukuri paraqitet për shkak të shpejtësisë së qarkullimit, numrit të madh të kontratave të cilat lidhen çdo ditë,

Teoria klasike kontratat formulare “gati se nuk i njeh fare, meqenëse zbatimi i tyre ka qenë me numër të vogël. Përmenden kontratat mbi shitblerjen e sendeve në ankand publik si shembull i kontratave formulare (ku kushtet e shitjes janë sipas rregullës që më herët të caktuara).¹

Mirëpo, pa dyshim këto kanë qenë raste të jashtëzakonshme ashtu që kontratat formulare, si dukuri në jetën

¹ Colin, Capitan et Morandiér, *Traité de droit civil*, t. II, Paris, 1964, fq. 320

juridike, paraqiten në fund të shekullit XIX dhe në fillim të atij XX. Ato janë si rezultat i marrëdhënieve shoqërore shumë të zhvilluara, në të cilat paraqitet pabarazia ekonomike e palëve kontraktuese të personave fizikë ose juridikë, dhe kur shpejtësia dhe frekuenca e lidhjes së punëve juridike kërkon një teknikë të veçantë të lidhjes së kontratave, të cilat e përjashtojnë ose e sjellin në një masë të vogël mundësinë e negociatave për kohë të gjatë. Kështu, kontratat formuare së pari paraqiten në fushën e të ashtuquajturave shërbime publike p.sh. transportimi hekurudhor, detar ose ajror, kryerja e shërbimeve postale etj.,² në të cilat njëra palë kontraktuese është ndërmarrje e fuqishme që ia dikton kushtet palës kontraktuese më të dobët ekonomikisht. Shkaku mund të vërehet në kërkesën gjithnjë e më të madhe të *shpejtësisë së lidhjes së kontratës* në një marrëdhënie të caktuar kontraktore të standardizuar dhe të unifikuar për shkak të *prodhimtarisë masive* dhe *produkteve standarde*, me ç'rast teknika e lidhjes së kontratave me anë të formularëve ose me çmime të prera (fikëse) paraqitet si e domosdoshme³.

Procesi i racionalizimit në prodhimtarinë e theksuar të mallrave "tipizimi, standardizimi i prodhimit, rritja e ndërmarrjeve ekonomike, urbanizimi dhe shfrytëzimi i mjeteve të shpejta të komunikimit, nxit nevojën që edhe lidhja e kontratave të shpejtohet, të lehtësohet në rast se kemi të bëjmë me produkte të tipizuara".⁴ Për këtë arsye, gjithnjë e më shumë zbatohen formularët, kështu që me rastin e lidhjes konkrete të kontratës "nuk ekziston nevoja e domosdoshme që kontrata të përgatitet me kujdes dhe për një kohë të gjatë, meqënëse përvoja e ndërmarrjeve ekonomike që përdorin kontrata formulare është shprehur, saktësuar dhe detajizuar në tekstin e kushteve të përgjithshme të tyre".⁵

1. Karakteristikat e kontratave formulare

Sipas kriterit që rrjedh nga dispozitat juridike të nenit 142 al. 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 të ish - RSFJ-së, kontrata formulare janë ato të cilat lidhen "... me pranimin pa kusht të ofertës së përgjithshme dhe të përhershme, të cilën njëra nga palët kontraktuese publikisht ua dërgon numrit të pacaktuar të personave pa mundësi që pranuesi të marrë pjesë në caktimin e përmbajtjes së kontratës".

² Komentar Zakona o Obligacionim Odnosima (ZOO), redaksia, Dr. Slobodan Perović, Savremena administracija, Beograd, 1995, fq. 285.

³ Po aty.

⁴ Dr. Aleksandar Goldštanj, "Privredno ugovorno pravo", Informator, Zagreb, 1967, fq. 142.

⁵ Po aty.

Nga ky përkufizim rrjedhin edhe karakteristika të caktuara të kontratave formulare, siç janë: pranimi pa kusht i ofertës; oferta (për kontratën formulare) është e përgjithshme, e përhershme dhe publike; pamundësia e të ofertuarit të ndikojë në përmbajtjen e kontratës dhe superioriteti ekonomik i ofertuesit. Këtu do të ndalemi më hollësisht në analizën e këtyre karakteristikave.

1.1. Pranimi pa kusht i ofertës

Karakteristikë kryesore e kontratave formulare është se “përmbajtja e kontratës është në tërësi e njëjtë me përmbajtjen e ofertës. I ofertuari mund ta lidhë kontratën vetëm nëse në tërësi”⁶ e pranon ofertën. Prandaj, ai i cili dëshiron të lidhë kontratë me ofertuesin, për realizimin e qëllimeve të caktuara, mundet vetëm “en block” ta pranojë ofertën. Kjo karakteristikë e kontratave formulare e ka shtyrë juristin e famshëm francez, Salej, “t’i quajë këto kontrata si kontrata të adezionit “contract d’adhesion”.⁷

1.2. Oferta është e përgjithshme, e përhershme dhe publike

Karakteristika juridike e kontratave formulare pasqyrohet në mënyrën e veçantë, përkatësisht në teknikën e lidhjes së tyre. Ndryshe nga kontratat me përmbajtjen e caktuar në të cilën ku të dy palët kontraktuese me marrëveshje të përbashkët i caktojnë elementet dhe kushtet e kontratës, në kontratat formulare “oferta për lidhjen e saj është e përgjithshme dhe e përhershme” (neni 33 i LMD).

Oferta, me pranimin pa kusht të së cilës krijohet dhe lidhet kontrata formulare, i drejtohet numrit të pacaktuar dhe të pakufizuar të personave. Çdo person që dëshiron dhe ka për qëllim të lidhë kontratën duhet të veprojë në mbështetje të kushteve të parapara në ofertë.

Karakteri i përgjithshëm i ofertës shprehet me faktin se “oferta i drejtohet një numri të pacaktuar dhe të pakufizuar personash dhe çdo person mund ta pranojë ofertën në tërësi, dhe në çdo rast përmbajtja e ofertës bëhet përmbajtje e kontratës”⁸ p.sh. ndërmarrja ekonomike që mirret me transportimin e mallrave, “që më përpara shpall në mënyrë publike dhe të unifikuar mënyrën e kushteve të kontratës mbi transportimin, tarifën etj., ashtu që çdo person madhor ka mundësi t’i aderohet kësaj oferte gjenerale dhe në këtë mënyrë të lidhë kontratën për transportim”.⁹

⁶ Aleksandar Lojpur, *Opšti uslovi formularnih ugovora*, Pravni život br. 10-11, Beograd 1988, fq. 204.

⁷ Dr. S. Perović, vep. e cit, fq. 50; A. Lojpur, artikulli i njëjtë fq. 204.

⁸ Dr. I. Bukljaš, *Komentar ZOO, Opći i posebni dio obligacije*, Zagreb, 1980, fq. 23.

⁹ *Komentar ZOO redakcia S. Perović*, Beograd 1995, fq. 294.

Rrethana se një mall prodhohet dhe në treg ofrohet në sasi të mëdha, imponon nevojën e domosdoshme që shitja të bëhet me anë të ofertës së përhershme, deri në atë çast kur ofertuesi ka nevojë për lidhjen e kontratave të tilla. Oferta e përgjithshme është edhe e përhershme, sepse nuk shuhet në rast se e kanë pranuar ofertën një a më shumë persona. Ajo “zgjat derisa nuk kalon koha e lidhmërisë së ofertuesit me këtë ofertë dhe në bazë të saj mund të lidhen shumë kontrata me përmbajtje të njëjtë me persona të njëjtë ose të ndryshëm”.¹⁰ Karakteri i përhershëm i ofertës në kontratat formulare është pra rezultat i asaj se oferta buron nga veprimtaria e rregullt dhe e përhershme e ofertuesit.

Vlen të theksohet se “si ofertë e përgjithshme nuk konsiderohet dërgimi i katalogeve, listës së çmimeve, tarifat, lajmërimet e ndryshme, si dhe shpalljet e bëra me anë të shtypit, radios, televizionit ose në çfarëdo mënyre tjetër. Këto propozime, edhe pse i dërgohen dhe i drejtohen numrit të pacaktuar dhe të pakufizuar të personave, nuk paraqesin sipas nenit 35 të LMD ofertë për lidhjen e kontratës por vetëm thirrje që të bëhet oferta sipas kushteve të paraqitura në ofertë”. Ekspozimi i mallit me çmimin e caktuar, gjithashtu nuk hyn në fushën e zbatimit të nenit 33 të ligjit, sepse kjo formë e ofertës e paraqitur publike është e rregulluar me dispozitë juridike të veçantë të LMD (neni 34). Duke pasur parasysh faktin se dërgimi i katalogeve dhe i shpalljeve, si dhe ekspozimi i mallit nuk hyn në suazat e zbatimit të këtij neni, si dhe duke konsideruar se oferta sipas përkufizimit ligjor të paraqitur në nenin 32 të LMD duhet të jetë “drejtuar prej personit të caktuar”, shtrohet çështja e caktimit në mënyrë pozitive të propozimit për lidhjen e kontratës e cila në praktikë duhet të konsiderohet si ofertë e përgjithshme në kuptimin e këtij neni të LMD. Është mendim i përgjithshëm se ofertë e përgjithshme konsiderohet oferta e përmbajtur në kushtet e përgjithshme të afarizmit. Në dobi të kualifikimit të kushteve të përgjithshme të afarizmit si ofertë e përgjithshme, “theksohen këto rrethana:

a) Kushtet e përgjithshme të afarizmit sikurse edhe oferta e përgjithshme u drejtohen një numri të pacaktuar personash;

b) Në bazë të kushteve të përgjithshme lidhen kontrata me përmbajtje thuaja të njëjtë me çdo person që i pranon”.¹¹

Megjithatë do theksuar se sado që ka “argumente” për kualifikimin e kushteve të përgjithshme të afarizmit si ofertë e përgjithshme këto dy kategori nuk mund të identifikohen, përveç në disa raste të caktuara në

¹⁰ Dr. S. Perović, vep. e cit, fq. 50; A. Lojpur, artikulli i njëjtë fq. 205; Dr. I. Bukljaš, Komentari ZOO, Zagreb, 1980, fq. 81.

¹¹ Komentari ZOO redakcia S. Perović, Beograd 1995, fq. 81.

të cilat përputhen. Lëmenjë të tillë janë: veprimtaritë të cilat konsiderohen si shërbime publike (ofrimi i shërbimeve komunale, transporti publik, shërbimet postale të PTT etj.). Ndërmarrjet që merren me kryerjen e këtyre veprimtarive veprojnë në bazë të kushteve të përgjithshme të afarizmit në të cilat përmbahen edhe elementet thelbësore. Oferta e inkorporuar në kushtet e tilla të përgjithshme është e përgjithshme dhe me karakter të përhershëm, që d.m.th. se u drejtohet numrit të pacaktuar dhe të pakufizuar të personave, në kushte të njëjta. Në këtë rast "gjatë vlerësimit se a ekziston oferta e përgjithshme apo jo, duhet të nisemi nga karakteri i veprimtarisë së ofertuesit. Në rast se nga veprimtaria e tij rrjedh detyrimi për të lidhur kontratë me çdo person të interesuar, kemi të bëjmë me ofertë të përgjithshme".¹²

1.3. Pamundësia e të ofertuarit të ndikojë në përmbajtjen e kontratës

Kjo është njëra prej veçorive juridike të kontratave formulare në përgjithësi. Liria e palëve kontraktuese për caktimin e përmbajtjes së kontratës nuk është e pakufizuar. Pala më e dobët ekonomikisht duhet të mbrohet nga keqpërdorimi si pasojë e fuqisë ekonomike të kontraktuesit në pozitë superiore. Kështu "gjatë lidhjes së shpejtë të kontratave (quick - hand transactions), p.sh. në shtëpi të mallrave, në vetë natyrën e gjërave ose në pajtim me doket afariste blerësi nuk ka kohë t'i lexojë kushtet të cilat mund të jenë para syve të tij. Fjala është për njeriun në nxitim (man in a hurry). Sipas shumicës së autorëve, blerësi duhet t'i lexojë kushtet e përgjithshme ose të bartë rrezikun se në të diçka do të zbatohet edhe pse nuk ka qenë i njoftuar me përmbajtjen e kushteve të përgjithshme".¹³ Me kontratat formulare pranuesi i ofertës pa vënë kushte e pranon ofertën. Këtu "thelbi qëndron në atë që edhe nëse ofertuesi dëshiron një gjë të tillë, nuk mund të ndikojë në përcaktimin e përmbajtjes së kontratës. Personi që paraqitet si i autorizuar i ofertuesit, me rastin e lidhjes së kontratës nuk ka autorizim që të ndryshojë diçka në ofertë. Përmbajtjen e kontratës së ardhshme ofertuesi e formulon më përpara, për një numër të pacaktuar rastesh, dhe aty askush nuk mund të ndryshojë asgjë".¹⁴ Në kontratat formulare klauzolat kontraktuese përpilohen në mënyrë të njëanshme dhe pala tjetër ka mundësi t'i pranojë ose t'i refuzojë "En Block". U mbetet palëve kontraktuese që "me zgjedhjen e tyre të shfrytëzojnë formularin e përgatitur qysh më përpara, në të cilin janë dhënë saktësisht të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese. Këto kontrata zbatohen jo

¹² Po aty, fq. 82.

¹³ Dr. Aleksandar Goldštanj, "Privredno ugovorno pravo", Informator, Zagreb, 1967, fq. 144.

¹⁴ A. Lojpur, artikulli i njëjtë, fq. 205.

vetëm kur palët kontraktuese në to thirren shprehimisht por edhe hesh-tazi ashtu që çdo herë e më shumë paraqiten si rregulla të sjelljes në degë të caktuara ekonomike a tregtare”.¹⁵ Kjo veçori juridike është “rrjedhje e domosdoshme e mënyrës së prodhimit, e shitjes së mallrave dhe e dhënies së shërbimeve në epokën industriale. Qarkullimi i mallrave është shumë i shpejtë në kushtet e jetës bashkëkohore ashtu që nuk ka mundësi dhe nevojë për “negociata të veçanta”¹⁶ të palëve kontraktuese.

1.4. Superioriteti ekonomik i ofertuesit

Është njëra prej veçorive juridike me rëndësi të veçantë për kontratat formulare. Shumica e autorëve që janë marrë me studimin e kontratave formulare e theksojnë pozitën superiore ose ekonomike të palës kontraktuese që i dikton kushtet për lidhjen e kontratës ndaj palës e cila i aderohet kontratës. Si ofertues zakonisht, paraqiten korporatat e fuqishme prodhuese dhe tregtare, prodhuesit e mallrave dhe dhënësit e shërbimeve pa të cilët nuk mund të paramendohet jeta bashkëkohore. Pa dyshim, mund të themi se pabarazia ekonomike e palëve kontraktuese është e qartë dhe ekziston në këto kontrata. Pala kontraktuese e cila që më përpara i parashikon, i formulon dhe i paraqet kushtet e kontratës, “më së shpeshti është ndërmarrje e fuqishme me potencial të madh ekonomik, kurse pala kontraktuese e cila i pranon kushtet e tilla të parapara me kontratë është subjekt i cili në raport me palën tjetër ka fuqi ekonomike modeste”.¹⁷ Pra, “këta formularë i përgatit sipas rregullit, njëra palë kontraktuese dhe me rastin e lidhjes së kontratës ia paraqet palës tjetër e cila zakonisht nuk është në gjendje të ndryshojë asgjë në formularët e paraqitur të kontratës, por në tërësi e pranon “En Block”. Pala tjetër është e detyruar të lidhë kontratën në mënyrën e paraqitur për shkak se ofertuesi gëzon monopol në degë të caktuara”¹⁸ ekonomike. Pala e dobët ekonomikisht është e shtyrë nga *domosdoshmëria ekonomike t’i pranojë kushtet e diktuar* të kontratës edhe pse janë të pafavorshme për të. Ky faktor posaçërisht shprehet në veprimtarinë e ofrimit të shërbimeve të ndryshme komunale, p.sh. furnizimi me ujë, me energji elektrike, me gaz etj. Nga “domosdoshmëria për t’u furnizuar me sende të caktuara, të interesuarit nuk mund ta zgjedhin partnerin kontraktues, sepse pala më e fortë ekonomikisht mban monopolin juridik ose faktik për ta kryer veprimtarinë e caktuar ekono-

¹⁵ Dr. J. Vilus, Opšti uslovi formularni ugovora, Monografija 86, JUP, Bg,1976,, fq. 18.

¹⁶ A. Lojpur, artikulli i njëjtë, fq. 205.

¹⁷ Komentar ZOO redakcia S. Perović, Knjiga I, Savremena administracija, Beograd 1995, fq. 284.

¹⁸ Dr. J. Vilus, vep. e cit., fq. 6.

mike, ashtu që kontrata duhet të lidhet vetëm me të".¹⁹ Nga kjo nuk është vështirë të konstatohet se pabarazia ekonomike e palëve kontraktuese shkrihet në thelbin e kontratave formulare, si dhe fakti se këto kontrata në kuptimin e caktuar "paraqesin "rrezikshmëri" për palën kontraktuese të dobët ekonomikisht, sepse ajo është e shtyrë nga nevoja e domosdoshme që t'i pranojë kushtet, pa marrë parasysh se çfarë janë ato që i ofrohen nga pala tjetër. Pabarazia e palëve kontraktuese në thelb e shpjegon paraqitjen e kontratave formulare në planin ekonomik dhe sociologjik".²⁰

Në lidhje me këtë "superioriteti ekonomik i ofertuesit paraqitet si një element i rëndësishëm me rastin e interpretimit të ligjit dhe të kontratës, posaçërisht me rastin e interpretimit teleologjik, me ç'rast hulumtohet *ratio legis* në materien e kontratave formulare vërehet dukshëm se mbrojtja e palës ekonomikisht inferiore ishte motivi kryesor për një numër të madh zgjidhjesh ligjore të LMD".²¹

Me anë të "ligjeve antitruste rregullohet veprimtaria e ndërmarrjeve ekonomike të cilat gëzojnë pozitën monopoliste. Rregullat bashkëkohore e rregullojnë pozitën e ndërmarrjeve që kanë ndikim mbizotërues në treg. Kështu, dispozitat norvegjeze flasin për "dominant enterprise", ato holandeze për ndërmarrjet që kanë "dominant position", ato të Danimarkës për ndërmarrjet që në treg kanë "effective influence".²²

2. Subjektet që i përpilojnë kontratat formulare

Kontratat formulare mund t'i përpilojnë: *shoqatat tregtare private, firmat e caktuara, ndërmarrjet ekonomike, shoqatat e prodhuesve dhe organizatat ndërkombëtare.*

Karakteristika kryesore e kontratave formulare të përpiluara nga *shoqatat tregtare private* shprehet në atë që paraqiten si rregulla jo të detyrueshme e që tregtarët i shfrytëzojnë kur u duhet.

Në disa degë të rëndësishme (siç janë: transporti, sigurimi, shpeditcion) kontratat lidhen kryesisht në mbështetje të kushteve të përgjithshme dhe kanë rëndësi aq të madhe në praktikë, sa që njohja e tyre, sipas prof. Goldshtajnit, "thuaja se është thelbësore për përfaqësuesit e degës nga njohja e vet ligjit". Në këtë pikëpamje edhe mund të flitet për të *drej-tën korporative* (droit corporatif, corporate de la Erbrandsrecht).²³

¹⁹ Dr. Ž. Đorđević – V. Stanković, *Obligaciono pravo*, Opšti deo, Beograd, 1974, fq. 146.

²⁰ A. Lojpur, artikulli i njëjtë, fq. 206.

²¹ Po aty.

²² Dr. Aleksandar Goldštanj, "*Privredno ugovorno pravo*", informator, Zagreb, 1967, fq. 145.

²³ Vilus, Carić, Šogorov, *Međunarodna privredno pravo*, Beograd, 1984., fq. 70.

Kontratat formulare rrjedhin si nga “firmat e caktuara, ashtu edhe nga ndërmarrjet ekonomike ose shoqatat prodhuese. Shumica e tyre zbatohen shumë më gjerë, e jo vetëm ndërmjet anëtarëve të shoqatës të cilët kanë krijuar kontratën formulare. Kështu, ndër kontratat formulare që janë pranuar në ekonomi bëjnë pjesë: the London Corn Trade Association; the Incorporated Oil seed Association (London); the Refined Sugar Association (London); the Rubbes Trade Association, INC; the Coffe Inporters and Exporters Association etj.”²⁴ për të mbrojtur interesat e anëtarëve të tyre, këto korporata të fuqishme dhe asociacione kanë përpiluar kontrata formulare me të cilat paraprakisht kanë paraparë të gjitha klauzolat e nevojshme për kryerjen e punëve me sukses dhe në lehtësi.

a) Kontratat formulare të shoqatave tregtare

Shumica e firmave të njohura dhe shoqëritë tregtare në botë “(sidomos ato Britanike) janë të njohura me atë se për mallin me të cilin bëjnë tregti i përpilojnë kontratat formulare ose kushtet e përgjithshme, prej të cilave disa kanë arritur reputacionin ndërkombëtar dhe shfrytëzohen gjërisht. Në këtë plan gjithësi vlen të përmenden kontratat formulare; London Corn Trade Association (Angli), Association del comercio del Cereali e semi (në Itali) dhe Comite Von Groonhandelaren për shitjen e drithërave, Federation of Oil Seed and Fats Association për shitjen e vajit dhe të yndyrërave, International Council of Hids and Skin Sallers Association për shitjen e drurit, Bremen Baumöllbörse për tregti me pambuk dhe lesh”²⁵ ndërsa “në fushën e punëve investive shfrytëzohen kushtet e përgjithshme të përpiluara nga Federata Ndërkombëtare e Konsulting – Inxhinieringut (të ashtuquajtura kushtet e përgjithshme Fidic)”²⁶

b) Kontratat formulare të organizatave ndërkombëtare

Nga organizatat ndërkombëtare që merren me përpilimin e kontratave formulare rol të rëndësishëm dhe vend meritor ka Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën, i cili në kuptimin e tillë ka përpiluar një numër të madh kontratash tipe dhe kushtet e përgjithshme.²⁷ Kjo organizatë ka luajtur rol pionieri me rastin e përpilimit të kushteve të përgjithshme dedikuar importimit, eksportimit dhe montazhimit të pajisjeve investive, meqë për këto nuk ka pasur mostra. Oda Ekonomike në Paris, gjithashtu, merret me kodifikimin e rregullave eko-

²⁴ Dr. A. Goldštanj, *Pravo međunarodne kupoprodaje*, informator Zagreb, 1963, fq. 72.

²⁵ Vilus, Carić, Šogorov, vep. e cit., fq. 70.

²⁶ Po aty, fq. 71.

²⁷ (Për këtë çështje do të diskutohet te kontrata e shitjes ndërkombëtare).

nomike dedikuar tregtisë ndërkombëtare, prandaj lidhur me këtë vlen të përmenden Incoterms 1980.²⁸ Rregullat e unifikuara dhe Doket për Akreditivin Dokumentar të vitit 1984. Përveç Komisionit ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën, këtu duhet përmendur edhe Këshillin për Ndhimë Ekonomike Reciproke (KNER) (i cili më nuk ekziston) që "ka përpiluar kushtet e përgjithshme që shfrytëzohen në transaksionet ndërmjet vendeve anëtare të organizatave rajonale, mirëpo këto kushte të përgjithshme nuk hyjnë në kategorinë e rregullave juridike dispozitive, për arsye se zbatimi i tyre është i detyrueshëm për shtetet anëtare të KNER-it".²⁹

Komisioni i KB për të Drejtën Ndërkombëtare Tregtare (UNCITRAL) është angazhuar për përpilimin e kushteve të përgjithshme "gjenerale" ("general" general conditione"), të cilat do t'u referoheshin të gjitha llojeve të shitjes (ngjashëm me kushtet e KNER-it). Nga ky projekt është hequr dorë kur komisioni ka vendosur t'i qaset revizionit të ligjeve uniforme të Hagës që ka sjellë miratimin e Konventës për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave 1980.³⁰

²⁸ Versioni i parë i rregullave i INCOTERMSIT është nxjerrë në vitin 1933. Incoterms është shkurtësë për terma tregtare ndërkombëtare, me të cilat rregullohen të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese lidhur me dërgimin e mallrave, shpenzimet e dërgimit dhe momentin e kalimit të rrezikut për dëmtimin eventual të sendit nga shitësi në blerësin (p.sh. C.I.F., F.O.B., C&F, F.A.S. etj.). Versioni i fundit i INCOTERMS është bërë në vitin 1990. (Ralph H. Folsom, Michael W. Gordon, John A. Spanogle, Međunarodni trgovački poslovi u sažetom obliku, Prijevod s engleskog Dragan Golubović, Pravni Fakultet Sveučilište u Rijeci, 1998, fq. 57.

²⁹ Vilus, Carić, Šogorov, vep. e cit., fq. 71.

³⁰ Kjo konventë është miratuar në Konferencën diplomatike të Vjenës më 10.4.1980, e konvokuar nga OKB. Në këtë Konferencë kanë marrë pjesë 62 anëtarë të KB (edhe pse nuk janë mbledhur më tepër se 1/2 e anëtarëve megjithate mund të thuhet se sipas kriteriumit të kodifikimit është përmbushur kushti për univerzalitetin e Konferencës). (Cit. sipas Dr. J. Vilus, Komentar Konvencije Ujedinjenih nacija o međunarodnoj prodaje robe, 1980, Obvezno pravo, Druga Knjiga, Zagreb, 1981 fq. V). Rezultatit më të ri në unifikimin e së drejtës materiale e paraqet nxjerrja e Konventës së Vjenës mbi shitjen ndërkombëtare të mallrave. Historiati i kësaj Konvente mund të ndahet në tri faza. Në fazën e parë, ekspertët juridik evropian të tubuar rreth Institutit për unifikimin e së drejtës private (UNIDROIT) kanë përgatitur disa projekt tekste të konventave të ardhme. Faza e dytë ka përfunduar me dy ligje uniforme të vitit 1964; Ligji mbi shitblerjen ndërkombëtare të sendeve të lujtshme trupore (ULIS) dhe Ligji mbi lidhjen e kontratave mbi shitblerjen e sendeve të lujtshme trupore (ULFC). (Jednoobrazni zakon o međunarodnoj prodaji telesnih pokretnih stvari i Jedno obrazni zakon o zaključivanju ugovora o međunarodnoj prodaji telesni pokretnih stvari sa odgovarajućim konvencijama - Institut za uporedno pravo, seria E, broj 44, Bg. 1966, Predgovor Prof. B. Blagojević). Më hollësisht për këtë çështje shih punimin e Mr. Gašo Knežević, Haška

Një “mesatare ndërmjet kodifikimeve autonome të së drejtës formulare të agjencive ndërkombëtare dhe kontratave formulare të firmave dhe shoqatave të veçanta paraqesin përpjekjet e shoqatave shkencore, të cilat synojnë që ekonomisë t’i paraqesin për shfrytëzim rregullat të cilat kanë mundësi që afaristët t’i shfrytëzojnë në veprimtarinë e tyre. Ndër to duhet theksuar International La Association – ILA (Shoqata për të Drejtën Ndërkombëtare e themeluar në vitin 1873), Instituti për Unifikimin e të Drejtës Private – *Undroit* në Romë (i themeluar në vitin 1926) etj. Shoqatat e tilla e analizojnë praktikën dhe formulojnë zgjidhje të cilat i shërbejnë drejtpërdrejt praktikës, ose si platformë e legjislaturës së brendshme a ndërkombëtare”.³¹

Aktiviteti i tyre (shoqatave dhe asociacioneve) është mjaft i madh që është shprehur “në përpilimin e një numri të madh të klauzolave tipe për kontratat ndërkombëtare tregtare”.³²

3. Teknika e lidhjes së kontratave formulare

Teknika e lidhjes së kontratave formulare dallohet nga ajo e lidhjes së kontratave të tjera të së drejtës së detyrimeve.

Për shkak të zhvillimit “të hovshëm të ekonomisë, aspiratës dhe tendencës për zhvillimin edhe më të shpejtë të këmbimit të mallrave, ekziston edhe mënyra e veçantë, e shpejtë dhe efikase e lidhjes së kontratave në ekonomi e quajtur lidhja e kontratave formulare”.³³ Specifikat e lidhjes së kontratave formulare (sikurse edhe të kontratave në ekonomi në përgjithësi) shprehin “kryesisht në afatet në të cilat ofertuesi është i lidhur me ofertën, në kufizimin e autonomisë së vullnetit me rastin e lidhjes së kontratës, zgjerimin e kushteve për lidhjen e kontratave në heshtje, si dhe me rigozitetin e përgjegjësisë për pasojat e dëmshme të përfaqësimit jo të rregullt me rastin e lidhjes së kontratës. Në kushtet e jetës bashkëkohore një numër i madh operacionesh në marrëdhëniet juridike – ekonomike bëhen me krijimin e marrëdhënieve kontraktore në bazë të kushteve që më përpara të vërtetuara në të cilat njëra palë kontraktuese lidh kontratat (kushtet e përgjithshme të afarizmit) dhe deklarimit të palës tjetër, në rast se dëshiron lidhjen e punës, t’i pranojë këto kushte. Në rastin konkret vendosja e marrëdhënieve kontraktore me deklarimin se i pranon kush-

konvencija o merodavnom pravu za ugovore o međunarodnoj prodaju robe iz 1985, Strani pravni život, seria D, br. 130-131, Bg. 1986, fq. 27-34.

³¹ Dr. A. Goldštanj, *Pravo međunarodne kupoprodaje*, informator Zagreb, 1963, fq. 72.

³² Dr. M. Draškić, vep. e cit., fq. 18.

³³ Dr. Boris Vizner, Dr. Vladimir Kapor, Dr. Slavko Carić, *Ugovori građanskog i privrednog prava*, Rijeka 1971, fq. 53.

tet e përgjithshme të afarizmit e ka rëndësinë e pranimit të ofertës gjenerale të palës tjetër. Ky pranim shprehet në dy forma; lidhja e kontratave të adezionit dhe e kontratave tipe.

Lidhja e kontratave formulare dallohet nga mënyra e rëndomtë e lidhjes së kontratave në përgjithësi. Oferta për lidhjen e këtyre kontratave i përmban të gjitha kushtet, duke përfshirë edhe çështjet e hollësishtme, përveç atyre që për nga natyra e gjërave palët mund të merren vesh, siç janë: sasia, numri e të tjera. Kështu, p.sh. personat juridikë shoqërorë që merren me transportimin ajror të udhëtarëve dhe mallrave që më parë publikojnë kushtet e kontratës mbi transportimin, tarifën e veçantë etj, ashtu që secili subjekt me zotësi veprimi ka mundësi t'i aderohet kësaj oferte të përgjithshme dhe në këtë mënyrë të lidhë kontratën për transportim. Kontrata këtu lidhet në atë mënyrë që pala tjetër (i ofertuari) e pranon ofertën e tillë të përgjithshme, si dhe kushtet e ofertës gjenerale mbeten si përmbajtje e kontratës në mes ofertuesit dhe të ofertuarit. Përmisht, nuk mund të kërkohet kurrfarë ndryshimi i kushteve të parapara me ofertë. Personi i interesuar ka mundësi që ofertën ta pranojë në tërësi ashtu siç është ose të mos e pranojë.

Kushtet në bazë të të cilave mund të lidhen këto kontrata, ose siç quhen "kushtet e përgjithshme", mund t'i paraqiten opinionit në mënyra të ndryshme, por zakonisht ato janë "formularë të shtypur që shërbejnë si dokumente për kontratën, ose si rregulla të përgjithshme për tarifën, listën e çmimeve, katalogjeve e të tjera".³⁴ Për lidhjen e kontratave formulare me rëndësi qenësore është që "kushtet e përgjithshme" në çastin kur lidhet kontrata, t'i jenë të njohura palës që ka qëllim ta lidhë kontratën, por ka mundësi që palët në kontratë të paraqesin edhe klauzola të veçanta".³⁵ Kontrata formulare e lidhur i detyron palët kontraktuese në rast se plotësohen "dy kushte kryesore: së pari, në rast se pala e ka nënshkruar formularin dhe, së dyti, se në çastin kur lidhet kontrata e tillë, pala kontraktuese që nuk ka marrë pjesë në përpilimin e kontratës i ka njohur ato kushte që i ka përmbajtja e kontratës".³⁶ Ky kusht është paraparë shprehimisht në KC të Shqipërisë në nenin 686, në nenin 142, al. 3 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të ish-Jugosllavisë, në nenin 1341 të KC të Italisë etj. Kontratat formulare "mund të lidhen shprehimisht ose heshtazi, p.sh. me nënshkrimin e formularit kontraktues i cili i përmban kushtet e përgjithshme të shtypura, nënshkrimin e dokumentit mbi kon-

³⁴ Dr. S. Perović, *Obligaciono pravo*, Opšti deo, Beograd 1986, fq. 218.

³⁵ Dr. S. Perović, vep. e cit, fq. 218; Dr. Ž. Đorđević – V. Stanković, *Obligaciono pravo*, Opšti deo, Beograd, 1974, fq. 145.

³⁶ J. Radišić, *Obligaciono pravo*, Opšti deo, Beograd, 1979, fq. 84.

tratën e cila nuk i përmban “kushtet e përgjithshme” por në të cilën thirren; me pranimin e ofertës në të cilën janë paraqitur “kushtet e përgjithshme”, ose me ekzekutimin e dekretit në të cilin dekretdhënësi thirret në kushtet e veta të përgjithshme”.³⁷ Në pikëpamje të teknikës juridike përdorimi i formularëve të ndryshëm e lehtëson lidhjen e kontratës, meqë e thjeshton dhe e standardizon teknikën e kontraktimit, përdorimin e dokumenteve dhe interpretimin e termave, kështu që në këtë mënyrë pa humbje të madhe kohe dhe pa përpjekje të mëdha lidhet kontrata. Me këtë njëkohësisht palëve kontraktuese u bëhet mundshme që me rastin e bisedimeve ta përqëndrojnë vëmendjen në çështjet me rëndësi, siç janë: çmimi, cilësia, sasia, afati i dërgimit të gjërave (sendeve), afati i pagesës etj. Në të gjitha këto raste kërkohet që kushtet e përgjithshme të jenë të njohura për palën në çastin kur lidhet kontrata. Kjo vlen edhe atëherë kur zbatimi i kushteve të përgjithshme është i zakonshëm në degë të caktuara ekonomike, po qe se teksti i tyre është paraqitur publikisht në zyrat, vendet e punës së hartuesit dhe nëse pala tjetër ka pasur mundësi t’i njohë ato (neni 142 al. 1, 2, 3 të LMD).

Kontratat formulare mund të përbëhen prej “kushteve të përgjithshme” dhe kontratave të aderimit.

Përfundimi

Teknika e lidhjes së kontratave formulare dallohet nga ajo e lidhjes së kontratave të tjera të së drejtës së detyrimeve.

Për shkak të zhvillimit të hovshëm të ekonomisë, aspiratës dhe tendencës për zhvillimin edhe më të shpejtë të këmbimit të mallrave, ekziston edhe mënyra e veçantë, e shpejtë dhe efikase e lidhjes së kontratave në ekonomi e quajtur lidhja e kontratave formulare. Specifikat e lidhjes së kontratave formulare (sikurse edhe të kontratave në ekonomi në përgjithësi) shprehin kryesisht në afatet në të cilat ofertuesi është i lidhur me ofertën, në kufizimin e autonomisë së vullnetit me rastin e lidhjes së kontratës, zgjerimin e kushteve për lidhjen e kontratave në heshtje, si dhe me rigorozitetin e përgjegjësisë për pasojat e dëmshme të përfaqësimit jo të rregullt me rastin e lidhjes së kontratës. Në kushtet e jetës bashkëkohore një numër i madh operacionesh në marrëdhëniet juridike – ekonomike bëhen me krijimin e marrëdhënieve kontraktore në bazë të kushteve që më përpara të vërtetoheshin në të cilat njëra palë kontraktuese lidh kontratat (kushtet e përgjithshme të afarizmit) dhe deklarimit të palës tjetër, në rast se dëshiron lidhjen e punës, t’i pranojë këto

³⁷ Po aty.

kushte. Në rastin konkret vendosja e marrëdhënieve kontraktore me deklarimin se i pranon kushtet e përgjithshme të afarizmit e ka rëndësinë e pranimit të ofertës gjenerale të palës tjetër. Ky pranim shprehet në dy forma; lidhja e kontratave të adezionit dhe e kontratave tipe.

Lidhja e kontratave formulare dallohet nga mënyra e rëndomtë e lidhjes së kontratave në përgjithësi. Oferta për lidhjen e këtyre kontratave i përmban të gjitha kushtet, duke përfshirë edhe çështjet e hollësishme, përveç atyre që për nga natyra e gjërave palët mund të merren vesh, siç janë: sasia, numri e të tjera. Kështu, p.sh. personat juridikë shoqërorë që merren me transportimin ajror të udhëtarëve dhe mallrave që më parë publikojnë kushtet e kontratës mbi transportimin, tarifën e veçantë etj, ashtu që secili subjekt me zotësi veprimi ka mundësi t'i aderohet kësaj oferte të përgjithshme dhe në këtë mënyrë të lidhë kontratën për transportim. Kontrata këtu lidhet në atë mënyrë që pala tjetër (i ofertuari) e pranon ofertën e tillë të përgjithshme, si dhe kushtet e ofertës gjenerale mbeten si përmbajtje e kontratës në mes ofertuesit dhe të ofertuarit. Përkundrazi, nuk mund të kërkojë ndryshimi i kushteve të parapara me ofertë. Personi i interesuar ka mundësi që ofertën ta pranojë në tërësi ashtu siç është ose të mos e pranojë.

Kushtet në bazë të të cilave mund të lidhen këto kontrata, ose siç quhen "kushtet e përgjithshme", mund t'i paraqiten opinionit në mënyra të ndryshme, por zakonisht ato janë formularë të shtypur që shërbejnë si dokumente për kontratën, ose si rregulla të përgjithshme për tarifën, listën e çmimeve, katalogjeve e të tjera. Për lidhjen e kontratave formulare me rëndësi qenësore është që "kushtet e përgjithshme" në çastin kur lidhet kontrata, t'i jenë të njohura palës që ka për qëllim ta lidhë kontratën, por ka mundësi edhe të refuzon.

